



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike  
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Ulaganja  
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

---

Prishtinë, 20 shkurt 2020

**PROPOZIM PËR MASA TË RECIPROCITETIT PËR TË RREGULLUAR  
TREGTINË ME SERBINË DHE BOSNJË-HERCEGOVINËN**

parashtruar nga Grupi Punues për Barrierat Tregtare i Ministrisë

**1. Hyrje**

Republika e Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovina, Republika e Moldavisë, Mali i Zi, Serbia dhe Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në emër të Kosovës në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, kanë aderuar në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, e cila ka hyrë në fuqi më 1 maj 2007. Qëllimi kryesor i CEFTA-s ishte krijimi i një zone të tregtisë së lirë, përmirësimi i kushteve për të promovuar më tej investimet, zgjerimi i tregtisë me mallra dhe shërbime, dhe më e rëndësishmja eliminimi i barrierave në tregti dhe deformimeve të tregtisë, si dhe lehtësimi i lëvizjes së mallrave në tranzit dhe lëvizjes ndërkufitare të mallrave dhe shërbimeve midis palëve. Për më tepër, sipas marrëveshjes së CEFTA-s, një nga objektivat e nenit 1 është “*të eliminojë barrierat dhe deformimet e tregtisë dhe të lehtësojë lëvizjen e mallrave në transit dhe lëvizjen ndërkufitare të mallrave dhe shërbimeve ndërmjet territoreve të palëve*”. Tani kanë kaluar pothuajse 13 vjet të zbatimit të marrëveshjes së CEFTA-s dhe Republika e Kosovës vazhdimisht përballet me të njëjtat pengesa. Mosmarrëveshjet e pazgjidhura me Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën mbeten ende, përfshirë çështjet institucionale dhe ekonomike.

**2. Përmbledhje e parimeve kryesore të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT)**

Përderisa parimet e reciprocitetit dhe mosdiskriminimit dhe kombit më të favorizuar (KMF) janë shtyllat kryesore mbi të cilat bazohet sistemi i Marrëveshjes së Përgjithshme të Tarifave dhe Tregtisë (GATT), vlen të përmendet se çdo lloj marrëveshje e tregtisë së lirë bazohet në parimin e reciprocitetit dhe mund të zbatohet në mënyrë efektive vetëm nëse përmban edhe parimin e mosdiskriminimit. Në thelb, reciprocite-

ti dhe mosdiskriminimi shërbejnë si parime që funksionojnë së bashku për të dhënë një rezultat efikas të politikës tregtare duke eliminuar kufizimet në tregti. Për më tepër, sipas së drejtës ndërkombëtare, reciprociteti nënkupton të drejtën për barazi dhe respekt të ndërsjellë ndërmjet palëve. Koncepti i reciprocitetit përfshin idenë se marrëdhëniet bilaterale nuk mund të jenë të njëanshme, por detyrimisht përfshijnë nocionin *quid pro quo* (një për një). Nocioni më i qartë i reciprocitetit është “sjellja e njëjtë si pala tjetër”. Reciprociteti është një instrument për të arritur zhvillimin e besimit të ndërsjellë dhe detyrimeve afatgjata midis palëve, duke promovuar pajtueshmërinë me normat ndërkombëtare. Në këtë aspekt, është gjithashtu një mjet për të vendosur të drejtën për një përgjigje reciproke kur pala tjetër nuk jep të njëjtin trajtim që pret nga partnerët e saj. Kjo është pikërisht ajo që qeveria e Kosovës synon të zbatojë. Ne do të trajtojmë tregtinë me partnerët tanë të CEFTA-s saktësisht si trajtimi që na japin ata. Kjo është një praktikë e drejtë dhe ne kemi besim që do të stimulojë partnerët tanë tregtarë për të kërkuar zgjidhje miqësore për çdo problem që mund të ndikojë në marrëdhëniet tona bilaterale tregtare.

### 3. Politika tregtare e Kosovës

Akteri kryesor në hartimin e politikave tregtare në Kosovë është Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI),\* e mandatar për hartimin dhe zbatimin e politikave tregtare. Pas miratimit të Politikës Tregtare të Kosovës në vitin 2009, Qeveria e Kosovës filloi krijimin e një numri mekanizmesh koordinimi për të ndjekur me shpejtësi zbatimin e politikave tregtare dhe ekonomike dhe për të forcuar përfshirjen e sektorit privat në hartimin e politikave. Para krijimit të këtyre mekanizmave, koordinimi i politikave tregtare praktikisht mungonte në Kosovë. Këto mekanizma janë njohur zyrtarisht me Ligjin për Tregti me Jashtë të miratuar në gjysmën e dytë të vitit 2011. Një prej këtyre mekanizmave është Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik (KKZHE), i cili vepron si platformë kryesore këshilluese dhe vendimmarrëse për hartimin e politikave ekonomike dhe reforma, përfshirë politikën tregtare. Në këtë drejtim, instrumenti themelor ligjor në fushën e politikës tregtare është Ligji për Tregti me Jashtë dhe Ligji për Tregtinë e Brendshme. Qëllimi i Ligjit për Tregti me Jashtë është përcaktimi i rregullave të përgjithshme për funksionimin e tregtisë së jashtme ndërmjet personave të vendosur brenda dhe jashtë territorit të Kosovës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, duke përfshirë marrëveshjet e OBT-së, direktivat e Bashkimit Evropian, dhe dispozitat e CEFTA-s. Për më tepër, Ligji për Masat Antidamping dhe Masat Kundërbalancuese dhe Ligji për Masat Mbrojtëse në Importe janë në fuqi.

---

\* Tani Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS).

#### 4. Vendosja e tarifës ndaj Serbisë dhe Bosnjë-Hercegovinës

Më 6 nëntor 2018, Qeveria e Kosovës vendosi një tarifë doganore shtesë prej 10 për qind për mallrat që vijnë nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina dhe vendimi për ta rritur këtë tarifë në 100 për qind u mor më 21 nëntor 2018. Tarifa ka ndikuar negativisht në marrëdhëniet tona me partnerët e rëndësishëm politikë dhe tregtarë të cilët kanë deklaruar se Kosova është duke shkelur zotimet e saj ndërkombëtare. Masa u vendos sepse Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina nuk po i ofronin tregtarëve të Kosovës trajtim të barabartë me trajtimin që Kosova po i ofronte tregtarëve të tyre. Kjo ishte një situatë asimetrike që preku rëndë tregtinë bilaterale të Kosovës. Sidoqoftë, nuk ka asnjë provë të fortë përfundimtare se vendosja e tarifës ka sjellë përfitime të konsiderueshme për ekonominë e Kosovës.

Kosova i respekton zotimet e saj ndërkombëtare dhe kërkon të ketë marrëdhënie miqësore dhe konstruktive me të gjithë partnerët e saj tregtarë, por nuk mund të pranojë në asnjë rrethanë një situatë kur ekziston një trajtim asimetrik që prek rëndë interesat tona kombëtare.

Dihet mjaft mirë se Republika e Kosovës ka zbatuar Marrëveshjen e CEFTA-s që nga hyrja në fuqi e saj në vitin 2007, duke respektuar plotësisht dispozitat e saj. Përveç kësaj, Republika e Kosovës është një nga nënshkrueset e Traktatit të Komunitetit të Transportit të nënshkruar midis BE-së dhe gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Bosnjë-Hercegovinën dhe Serbinë.

Në këtë kontekst, Republika e Kosovës rithekson që mosnjohja e dokumenteve të saj të eksport-importit, përveç dokumenteve doganore, shkel **nenin 3** të Marrëveshjes së CEFTA-s që ndalon të gjitha masat sasiore dhe masat me efekt ekuivalent në Tregtinë Rajonale të CEFTA-s ku është e zbatueshme Marrëveshja CEFTA. Kjo masë në mënyrë të barabartë përbën një shkelje të **nenit 14** të Marrëveshjes së CEFTA-s për të cilën miratohet Protokollin shtesë 5 për zbatimin e zgjeruar të saj.

Për më tepër, **neni 12** i Traktatit të Komunitetit të Transportit të nënshkruar nga BE, Serbia, Bosnjë-Hercegovina dhe Republika e Kosovës së bashku me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, parashikon që nënshkruesit synojnë të zbatojnë Acquis përkatëse të BE-së për transportin rrugor. I njëjti Traktat përcakton në **nenin 15.2** të tij që të gjitha palët nënshkruese të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën, do të lehtësojnë procedurat administrative për kalimin nga një territor doganor në një tjetër, sipas dispozitave të bashkëpunimit doganor të marrëveshjeve të zbatueshme midis tyre, duke iu referuar bashkëpunimit administrativ midis autoriteteve doganore në Marrëveshjen e CEFTA-s.

Mbi të gjitha, **neni 16** i Traktatit të Komunitetit të Transportit përcakton se çdo diskriminim për shkak të kombësisë ndalohet me fushëveprimin e këtij Traktati. Në kontekst, Republika e Kosovës pret njohjen e automjeteve të regjistruara në Republikën e Kosovës nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina në përputhje me Direktivën e

Këshillit të BE-së 1999/37/EC të datës 29 prill 1999 për dokumentet e regjistrimit të automjeteve, siç pasqyrohet në Shtojcën I.3 të Traktatit, gjë e cila referohet në nenin 12 të tij.

Duke marrë parasysh të gjitha përpjekjet konstruktive të ndërmarra nga Republika e Kosovës në kontekstin e CEFTA-s që nga shkurti 2015 për t'i bërë thirrje palëve përkatëse të CEFTA-s që të respektojnë CEFTA-n, dhe pavarësisht se të gjitha kufizimet e lartpërmendura mbeten në fuqi, Republika e Kosovës ka vazhduar të respektojë zotimet e saj për tregti të lirë që rrjedhin nga CEFTA. Për më tepër, Republika e Kosovës, si nënshkruese e barabartë e Traktatit të Komunitetit të Transportit, ka bërë përpjekjet e saj të plota për përafrim me legjislacionin përkatës të BE-së, përfshirë Direktivën e BE-së 1999/37, dhe njëh automjetet e regjistruara në Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë.

Në këtë aspekt, Republika e Kosovës e konsideron nevojë urgjente miratimin e masa-ve balancuese prej 100 për qind dhe ndalimin e njohjes së dokumenteve tregtare që mbajnë ndonjë emër tjetër përveç emrit të saj kushtetues, në përgjigje të shkeljeve afatgjata të **nenit 3**, dhe **nenit 14** të CEFTA-s, dhe **nenit 16** të Traktatit të Komunitetit të Transportit.

Në kuadër të së drejtës ndërkombëtare publike, Republika e Kosovës konsideron se praktikat diskriminuese të lartpërmendura të Serbisë dhe Bosnjë-Hercegovinës mund të rrjedhin nga mosnjohja e Republikës së Kosovës nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina.

Në këtë aspekt, Republika e Kosovës konsideron se është e domosdoshme t'i referohet **nenit 63** të Konventës së Vjenës për Traktatet Ndërkombëtare, e cila thotë se mungesa e marrëdhënieve diplomatike ose konsullore midis palëve të një traktati nuk ndikon në marrëdhëniet juridike të vendosura midis tyre nga traktati, përveç kur ekzistenca e marrëdhënieve diplomatike ose konsullore është e domosdoshme për zbatimin e traktatit.

Tre nga shtatë palët e CEFTA-s nuk e njohin Kosovën. Dhe dy prej tyre janë tregtarët e parë dhe të dytë më të mëdhenj rajonalë në CEFTA. Kosova është vend pa dalje në det dhe ka një kufi të gjatë me Serbinë si ekonomia më e madhe në CEFTA, e cila nuk e njeh Kosovën.

Importet ose eksportet tona që kalojnë nëpër fqinjët tanë që nuk e njohin vendin tonë ndalen dhe u kërkohet të paraqesin certifikatat kombëtare të eksportit ose importit të atij vendi. Sepse vendi ynë konsiderohet si pjesë e tregut të tyre të brendshëm, ose regjistrimet e automjeteve tona nuk njihen nga ai vend, apo certifikatat tona të eksportit nuk pranohen sepse këto dokumente mbajnë emrin dhe flamurin tonë kushtetues.

Si mund të jetë ekonomia e Kosovës konkurruese kur ajo vazhdimisht ka qenë duke harmonizuar legjislacionin e saj me Acquis e BE-së ndërsa tregu i saj është dominuar

nga fqinjët që nuk e kanë njohur Kosovën, gjë që ka vënë në dyshim konkurrueshmërinë e produkteve të saj në aspektin e cilësisë dhe çmimeve në krahasim me produktet që vijnë nga BE-ja. Si mund të arrijnë kompanitë kosovare në tregjet e BE-së në kushte të barabarta nëse korridori i tyre më i shkurtër i transportit është i bllokuar për shkak të kësaj çështjeje politike? Si mund të jenë konkurrese në aspektin e çmimeve? Si mund të jetë ekonomia e Kosovës e gatshme në këto rrethana për anëtarësimin e saj përfundimtar në BE?

Mosnjohja e Kosovës është pengesa më e madhe jotarifore në CEFTA dhe është pengesa më e madhe në lehtësimin e transportit.

## **5. Rastet e identifikuar dhe të klasifikuara të barrierave tregtare të aplikuara nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina kundër Kosovës**

Kosova përballet me një deficit tregtar gjithnjë e më të madh, veçanërisht për tregtinë e mallrave. Fakti që Kosova ka nivelin më të ulët të eksporteve në rajon është shenjë e qartë e vështirësive të saj me të cilat përballen kompanitë e Kosovës brenda CEFTA-s, veçanërisht me Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën. Në të vërtetë, këto vështirësi lidhen drejtpërdrejt me barrierat tregtare, të ashtuquajturat Barrierat Jotarifore. Në këtë kontekst, barrierat në tregti zbatohen nga autoritetet serbe rregullisht si ndaj produkteve bujqësore ashtu edhe ndaj atyre jobujqësore që eksportohen nga Kosova në Serbi ose kalohen transit përmes territorit të Serbisë si importe ose eksporte kosovare. Barrierat e aplikuara nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina janë të kategorive të ndryshme:

- **Barrierat jotarifore** – kufizimet e vendosura në tregtinë tranzitore: kërkesa e Serbisë për tregtinë e mallrave me origjinë nga vendet e treta dhe të destinuara për në Kosovë e që kalojnë nëpër territorin e Serbisë, veçanërisht ato që i nënshtrohen kërkesave dokumentuese veterinare dhe fitosanitare për eksportet në Serbi;
- **Barrierat teknike në tregti** – kërkesat e palës serbe që eksportet e Kosovës t'i respektojnë standardet kombëtare të Serbisë;
- **Barrierat politike** – kërkesat e etiketimit nga pala serbe për autoritetet e Kosovës që nuk janë në përputhje me formatin e rënë dakord në kontekstin e marrëveshjes dypalëshe midis Serbisë dhe Kosovës nën kujdesin e BE-së; mosnjohja e automjeteve të regjistruara në Kosovë, përfshirë këtu edhe automjetet komerciale (d.m.th. kamionët).

Sipas secilës kategori, në vazhdim është dhënë një shpjegim i shkurtër i problemit:

Kërkesat për etiketim nga pala serbe për autoritetet e Kosovës nuk janë në përputhje me formatin e rënë dakord në kontekstin e marrëveshjes dypalëshe midis Serbisë dhe Kosovës nën kujdesin e BE-së. Në këtë aspekt, produktet bujqësore me origjinë

nga Kosova nuk lejohen të eksportohen për shkak të etiketës që tregon se produkti është bërë në Kosovë (shiko shtojcën 1).

Duke marrë parasysh shkëmbimin tonë tregtar me Serbinë për produktet bujqësore, procedurat e shumta të analizave testuese, kërkesat e shumta dhe proceset e gjata të inspektimit patën ndikim të konsiderueshëm negativ në kompanitë bujqësore kosovare. Kështu, shumë shpesh, kompanitë kosovare janë përballur me pengesa të papritura të ngritura nga Drejtoria e Veterinarisë e Serbisë, duke rritur kostot e eksportit dhe harxhimin e kohës me procedura të gjata të cilat rezultuan me kosto shtesë, duke i bërë produktet kosovare më pak konkurruese në tregun serb dhe duke i detyruar kompanitë kosovare nga eksportimi në Serbi. Analiza shtesë kërkohen për secilën dërgesë (gjë që krijon kosto shtesë për analizën dhe harxhon kohë për eksportuesin kosovar, dhe ky harxhim i kohës rezulton me kosto shtesë që duhet të paguhet për терминалет doganore, e krejt kjo çon në kthimin ose edhe shkatërrimin e produkteve të ndjeshme). Krahas analizës testuese, certifikatat veterinarë dhe fitosanitare të lëshuara nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës shumë shpesh nuk njihen nga autoriteti serb. Kjo është në kundërshtim me marrëveshjen e arritur në Bruksel midis dy vendeve.

Në pikat e kalimit kufitar dërgesat nuk mund të inspektoheshin për shkak të mungesës së inspektorëve veterinarë dhe fitosanitarë (më shumë kilometra të kaluara për dërgesën nënkupton më shumë kosto transporti). Për më tepër, në kufirin midis Kosovës dhe Serbisë, inspektorët veterinarë dhe fitosanitarë serbë punojnë me orar të shkurtuar. Pas orës 14:00 nuk ka prezencë të inspektorëve në kufi, e kjo detyron kamionët kosovarë të presin atje deri ditën tjetër. Kështu krijohen kosto shtesë për sa i përket kohës dhe parave për kompanitë kosovare.

Gjatë eksportit të disa produkteve bujqësore në tregun e Serbisë, kompanitë tregtare kosovare janë përballur me kushte të reja të vendosura nga autoritetet serbe. Dokumentet e autoriteteve kosovare të cilat janë të vulosura përmbajnë logon zyrtare dhe përshkrimin siç lëshohen për tregun e brendshëm apo tregjet e tjera. Megjithatë, për shkak se Serbia nuk e njeh Kosovën si shtet të pavarur, dokumentet zyrtare nuk pranohen nga autoritetet serbe. Madje një kërkesë e tillë aplikohet edhe për transportimin e mallrave, duke kërkuar që dokumentet e nevojshme për import të lëshohen nga autoritet serbe, jo nga ato kosovare. Për këto arsye, kompanitë kosovare përballen me pengesa të ngritura papritur nga dogana serbe, duke rritur kështu kostot e kalimit të kufijve për sa i përket kohës së humbur dhe parave, gjë që i bën produktet e Kosovës jashtëzakonisht jokonkurruese në tregjet serbe dhe ato ndërkombëtare.

Një problem tjetër për kompanitë kosovare është gjetja e partnerëve në Serbi, të cilët do të importonin produktet e Kosovës për shkak të pasojave që sjellin bashkëpunimet me kompanitë kosovare. Prandaj, shumica e eksporteve të Kosovës në Serbi janë të drejtuara për në Jugun e Serbisë, që është i banuar nga popullsia shqiptare – Lugina e Preshevës (duke përfshirë qytetet e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjes). Sido-

qoftë, nëse një kompani është e licencuar për produkte specifike nga institucionet e Kosovës (p.sh. kompanitë farmaceutike), në kufirin e Serbisë, autoritetet Serbe nuk e pranojnë atë licencë, duke kërkuar që licenca të jetë e lëshuar nga autoritetet në Serbi. Duhet pasur parasysh që kompanitë kosovare nuk mund të marrin licencë tjetër për tregun serb. Për më tepër duhet të theksojmë rastet e etiketimit të produkteve në të gjithë sektorët, për të cilat mallrat kosovare janë ndaluar dhe kthyer shumë herë për arsye se kanë pasur Kosovën në etiketime.

Që nga viti 2018, çështja e kalimit transit nëpër Serbi është bërë pengesë e madhe për kompanitë kosovare. Shumë kompani tregtare kosovare të cilat posedojnë dokumentet e nevojshme importojnë produkte të ndryshme dhe lëndë të para nga vendet e BE-së. Edhe pse kompanitë kosovare posedojnë dokumentet e nevojshme, probleme të natyrës së kalimit transit shfaqen vazhdimisht në kufirin serb. Autoritetet serbe kërkojnë nga kompanitë kosovare të sigurojnë një dokument ose certifikatë që duhet të lëshohet nga Ministria e Bujqësisë e Serbisë, e cila në vetvete nuk është në natyrën e kalimit transit (*shih shtojcën 2*). Çështja e kalimit transit nuk aplikohet vetëm gjatë importimit nga shtetet anëtare të BE-së dhe kalimit nëpër territorin serb, por edhe gjatë eksportimit në vendet e BE-së, ku kërkohet kalimi nëpër territorin serb. Në situata të tilla, kompanitë importuese kanë dy mundësi: ose të aplikojnë për licencë të importit (licencë të kalimit transit) që lëshohet nga Drejtoria e Veterinarisë e Serbisë (e cila merr kohë për t'u fituar dhe është e vlefshme vetëm për tre muaj) ose detyrohen të kthehen prapa dhe të shfrytëzojnë kufijtë e tjerë alternativë, e ku në të dyja rastet shkaktohen kosto shtesë.

Rast tjetër që vlen të përmendet lidhur me kompanitë kosovare është pamundësia e eksportimit të letrave të mbeturinave në Serbi, për shkak se kompania importuese nga Serbia nuk mund të merrte licencën e nevojshme nga Ministria e Mjedisit në Serbi për të importuar këto mallra nga Kosova. Kompanisë importuese serbe iu tha se licenca lëshohet për importe nga vende të tjera, por jo edhe nga Kosova, pasi që Kosova konsiderohet pjesë e Serbisë dhe prandaj ata nuk mund të lëshonin licencë për importimin e letrave të mbeturinave nga Kosova. Në këtë rast, kompania kosovare, për të pasur mundësi të tregtojë, duhej të hapte biznes të ri në Maqedoninë e Veriut dhe të eksportonte në Serbi, duke humbur kështu origjinën e Kosovës.

Kompanitë importuese kosovare që merren me importin e naftës dhe transportimin e gazit nga Serbia dikur përballeshin me pengesa të vazhdueshme tregtare të vendosura nga autoritetet serbe. Serbia vazhdimisht ka vendosur pengesa, në këtë rast duke mos pranuar certifikatën e ADR-së të shtetit të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Certifikatat ADR lëshohen nga kompani të akredituara nga institucioni përkatës nga Kosova dhe Maqedonia Veriore. **Sidoqoftë, ky është i vetmi rast që arriti një epilog/zgjidhje pas një aplikimi të masës së reciprocitetit.**

Dihet që Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina nuk i njohin targat e regjistrimit të automjeteve (civile dhe tregtare) të regjistruara në Kosovë. Prandaj, të gjitha eksportet dhe

importet nga Kosova në Serbi dhe tek vendet e treta, që kalojnë nëpër Serbi (i cili është korridori më i shkurtër i transportit për të arritur në vendet anëtare të Bashkimit Evropian në zonën qendrore dhe perëndimore) duhet të përdorin kamionët e regjistruar në Serbi ose vendet anëtare të BE-së, si Hungaria ose Austria, ose nga Palët e tjera të CEFTA-s siç është Maqedonia Veriore. Kjo dëshmohet shumë mirë në bazë të të dhënave sasiore përkatëse për tregtinë në shërbimet e transportit të Kosovës (të marra nga Banka Qendrore e Kosovës) të cilat kanë shënuar rënie qëkur Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina i kanë zbatuar këto masa penguese. Për më tepër, të dhënat tregojnë se Kosova është gjithmonë importuese neto e shërbimeve të transportit, gjë që dëshmon se Kosova nuk mund të përdorë kamionët e saj.

Vlen të përmendet se autoriteti serb nuk i përgjigjet autoritetit të Kosovës, në veçanti Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) për kryerjen dhe monitorimin e procesit të prodhimit për disa kafshë dhe produkte bimore. Mosrespektimi nga autoriteti serb rezultoi në atë që eksporti të mos jetë në gjendje të kryhet fare. Prandaj, vlen të përmendet se bizneset kosovare mirëpresin çdo herë inspektimet SPS për të kryer analizën e nevojshme.

Një ndërmarrje kosovare u përball me pengesë nga autoritetet serbe në lidhje me Ligjin për Prokurimin Publik. Ndërmarrjes kosovare i ishte ndaluar pjesëmarrja në tenderët e transportit ndërkombëtar, të shpallur nga Elektroekonomia serbe në shumën prej 8.000.000,00 eurosh për shkak të faktit se dokumentet e lëshuara nga institucionet zyrtare të Kosovës nuk njihen nga autoritetet serbe.

Prodhuesit e verës nuk mund të eksportojnë verë në shishe qelqi në Serbi për shkak të etiketës ku thuhet se produkti është prodhuar në Kosovë. Ata e eksportojnë verën në rezervuar të mëdhenj, por jo në shishe dhe pa etiketa.

Prodhuesit farmaceutikë nga Kosova nuk mund të eksportojnë në Serbi për shkak të kërkesës për t'u regjistruar si eksportues nga Kosova tek autoritetet serbe. Përveç kësaj, atyre iu është thënë se regjistrimi nuk do të pranohet nga autoritetet serbe pasi që ato nuk i pranojnë dokumentet e lëshuara nga autoritetet kosovare nëse dokumentet nuk kanë status neutral. Gjithashtu, për shkak të problemeve politike ishte e pamundur të gjendej një partner tregtar në Serbi.

Serbia nuk ka njohur asnjëherë asnjë nga afërsisht 400 diplomat që ishin certifikuar nga Asociacioni Evropian i Universiteteve (EAU), siç kërkohet me Marrëveshjen e Brukselit. Përveç kësaj, vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Serbisë kundër marrëveshjes për njohjen e diplomave ka komplikuar më tej procesin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja për MIK dhe protokollin teknik është marrëveshja e parë e nënshkruar midis të dyja vendeve, në mënyrë që të mundësohet rikthimi i autoriteteve shtetërore të Kosovës në dy pikat e kalimit kufitar (PKK) në Jarinjë dhe Bërnjak. Në këtë drejtim, vendosja e objekteve të MIK-ut nuk ka funksionuar fare në tri pikat e kalimit



kufitar, që përbëjnë një urë të marrëveshjes të arritur midis dy vendeve në dialogun e Brukselit të lehtësuar nga BE-ja. Për shembull, projektet në PKK në Merdarë janë pothuajse të përfunduara, por ndërprerjet paraqiten nga fakti se pala serbe refuzon të vendosë objektet e reja administrative në PKK në Merdarë, sipas marrëveshjes së MIK-ut. Kosova ka ndërtuar PKK në Mutivodë dhe është funksionale, por pala serbe nuk i përdor objektet e reja të financuara nga BE-ja, njëjtë siç është rasti edhe në Merdarë.

Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, dogana serbe në kundërshtim të marrëveshjes së arritur në Bruksel është duke përdorur vula paralele me mbishkrimin "Carinarnica Priština" (Stacioni doganor i Prishtinës). Serbia nuk i përmbahet marrëveshjes për njohje të ndërsjellë të vulave doganore, të arritur që nga viti 2011. Përveç kësaj, Serbia shkel rregullat e CEFTA-s, ku vendet janë marrë vesh të përdorin vulat e konfirmuara nga të gjitha shtetet e CEFTA-s.

## **6. Mekanizmat e mosmarrëveshjeve në kuadër të CEFTA-s**

Kosova ka ngritur ankesa në lidhje me këto masa në CEFTA, në vazhdimësi. Në mënyrë që të zgjidhen këto barrierat të paarsyetuara tregtare, Kosova ka ndërmarrë optionet e mëposhtme:

Së pari, të gjitha masat kufizuese të vendosura nga Serbia dhe BeH kundër Kosovës janë futur në Bazën e të dhënave të barrierave të qasjes në treg, edhe pse së fundmi kjo bazë e të dhënave nuk ishte funksionale dhe nuk është përditësuar me kohë dhe në mënyrë të përshtatshme nga të gjitha vendet anëtare të CEFTA-s. Në këtë aspekt, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është takuar me anëtarët e tjerë të CEFTA-s në nivel teknik, në kuadër të komiteteve dhe nënkomiteteve përkatëse të CEFTA-s, dhe gjithashtu në baza bilaterale me përfaqësuesit e Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, në mënyrë që të gjendej një zgjidhje. Të gjitha këto çështje janë trajtuar pranë organeve përkatëse në CEFTA, posaçërisht në Nënkomitetin për Barrierat/Masat Jotarifore dhe në organin më të lartë vendimmarrës, d.m.th. në Komitetin e Përbashkët, dhe nuk u gjetën zgjidhje të përhershme ose të përshtatshme për rastet kosovare.

Së dyti, për hir të transparencës, të gjitha rastet e përmendura më lart mund të vërtetohen nga të gjithë procesverbalet e këtij Nën-komiteti dhe takimeve të tjera brenda CEFTA-s, siç është niveli i Komitetit të Përbashkët; ku përfaqësuesit kosovarë kanë qenë të pranishëm dhe trajtuan çështjet; dhe gjithashtu në bazën e të dhënave për barrierat e qasjes në treg (MABD). Për çështjet e futura në MABD shihni shtojcën 3. Megjithatë, ne nuk mund të arrinim asnjë zgjidhje përmes organeve dhe Mekanizmit CEFTA. Përgjigja e dhënë nga pala serbe është se Serbia e njeh Kosovën si një treg të brendshëm, prandaj, për shkak të legjislacionit në fuqi, Kosova nuk mund të kishte qasje të plotë në tregun serb dhe e njëjta nuk mund të thuhet për Serbinë në lidhje me tregun e Kosovës. Gjithashtu, pala serbe theksoi se ata nuk janë në gjendje t'i traj-

tojnë këto çështje për shkak të natyrës politike, domethënë që zgjidhjet brenda kornizës së CEFTA-s nuk kanë prodhuar rezultatet e pritura.

Së treti, efektet e ndërmjetësimit të BE-së në dialogun midis Prishtinës dhe Beogradit në adresimin e rasteve përmes kornizës së CEFTA-s, si dhe përmes çështjeve bilaterale, nuk kanë qenë efektive për Kosovën në aspektin e zgjidhjes së pengesave të pa-justifikuara tregtare të zbatuara në baza të rregullta nga Serbia dhe BeH kundër kompanive kosovare. Prandaj, mund të supozojmë se nuk mund të gjendej një zgjidhje në kuadër të CEFTA-s, dhe duke pasur parasysh faktin se nuk kishte ndonjë përgjigje përkatëse bazuar në rregullat e CEFTA-s ose asnjë përgjigje brenda kornizës së CEFTA-s, brenda një periudhe të arsyeshme kohore (gjashtë muaj, ose një vit më së shumti), çështja e barrierave tregtare u shty përpara në nivel të BE-së. Prandaj, disa nga çështjet i janë adresuar Ministrisë së Dialogut të Kosovës, por për fat të keq nuk është siguruar zgjidhja e përhershme. Konkretisht, ka pasur disa raste të pengesave tregtare që janë diskutuar në nivelin dypalësh të negociatave në Bruksel, nga niveli i ekspertëve teknikë me ndërmjetësimin e BE-së, por megjithatë, nuk u zgjidhën asnjë prej rasteve; ose që nuk janë përsëritur. Përsëri, niveli dypalësh i negociatave në Bruksel nuk prodhoi ndonjë zgjidhje të qëndrueshme e as nuk zgjidhi asnjë rast për kompanitë kosovare.

## 7. Përfundimet

Si përfundim, ekzistojnë katër kategori kryesore të problemit:

- Kufizimet e vendosura në tregtinë tranzit: kërkesa e Serbisë për tregtinë e mallrave me origjinë nga vendet e treta dhe të destinuara për Kosovën që kalojnë nëpër territorin e Serbisë, veçanërisht ato që i nënshtrohen kërkesave për dokumente sanitare dhe fitosanitare për eksportet në Serbi
- Kërkesat nga pala serbe që eksportet e Kosovës të respektojnë standardet kombëtare të Serbisë
- Kërkesat për etiketim nga pala serbe për autoritetet kosovare nuk janë në harmoni me formatin e miratuar në kontekstin e marrëveshjes dypalëshe midis Serbisë dhe Kosovës nën patronatin e BE-së
- Mosnjohja e automjeteve të regjistruara në Kosovë përfshirë automjetet komerciale (d.m.th. kamionët)

Duke marrë parasysh këto praktika penguese të përdorura nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina, ato kanë rezultuar në kosto shtesë kohore dhe monetare për kompanitë kosovare, dhe si pasojë, ato nuk ishin në gjendje të ishin konkurruese në treg, padyshim mund të konkludohet nga rastet e përmendura më lart që Kosova përballlet me barrierat tregtare me vendet e CEFTA-s, veçanërisht me Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovina. Një situatë e tillë pasqyron pjesërisht faktin se Kosova nuk vendos

ndonjë barrierë specifike tregtare ndaj produkteve serbe dhe boshnjake, gjë që rezulton në akumulimin e disbalanceve afatgjata në kurriz të ekonomisë së Kosovës.

Me gjithë përfitimet ekonomike nga marrëveshja, Kosova, për fat të keq, nuk ka përfituar nga CEFTA në masën që pritej, për shkak të argumenteve të përmendura më lart dhe Kosova nuk ka përfituar në aspekt të trajtimit institucional, siç kanë përfituar Palët e tjera të CEFTA-s. Barrierë më e madhe është përfaqësimi i Kosovës në CEFTA përmes UNMIK-ut, duke gjeneruar kosto të konsiderueshme nga mos njohja.

Për më tepër, Serbia nuk ka respektuar marrëveshjen dypalëshe për përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal, të arritur në vitin 2012 që thotë qartë: *“Marrëveshja do të lejojë që Kosova të marrë pjesë dhe të nënshkruajë marrëveshje të reja për llogari të veta dhe të flasë për vetveten në të gjitha takimet rajonale, ( deri më tani marrëveshja është nënshkruar nga UNMIK-u në emër të Kosovës). Kosova\* do të jetë emërtimi i vetëm që do të përdoret dhe fusnota që do të aplikohet për yllin”*. Duke marrë parasysh pengesat e ndryshme me Serbinë, qartë se marrëveshja nuk është zbatuar nga ana e tyre.

## 8. Rruga e mundshme përpara

Duke pasur parasysh që dialogu dypalësh, mekanizmat e CEFTA-s dhe ndërmjetësimi i BE-së nuk ishin të suksesshme, Kosova ka mundësinë e fundit, megjithëse një mundësi e pakëndshme, të vendosë masa reciprociteti **në një mënyrë rreptësisht të balancuar** në marrëdhëniet e saj tregtare me Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën. Në atë kontekst, Kosova po shqyrton masat e reciprocitetit në fushat e mëposhtme:

- Masa reciprociteti për të gjitha dokumentet dhe praktikat që prekin çështjet tregtare;
- Masa reciprociteti për njohjen e të gjitha kualifikimeve profesionale (siç janë diplomatat, certifikatat, licencat, lejet etj. të lëshuara nga autoritetet kosovare);
- Masa reciprociteti për targat e automjeteve (autobusë, kamionë, vetura etj.);
- Masa reciprociteti për lëvizjen e lirë të personave, përfshirë njohjen e dokumenteve të lëshuara nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina siç janë pasaportat, letërnjoftimet dhe patentë-shoferët.

# SHTOJCAT

## Shtojca 1



## Shtojca 2

PRIMENO E-mailom

05.03.2018

Др. вет. н.л. ДУШКО МИЛИНКОВИЋ  
гранични ветеринарски  
инспектор

Република Србија  
МИНИСТАРСТВО ПОЉОПРИВРЕДЕ,  
ШУМАРСТВА И ВОДОПРИВРЕДЕ  
- УПРАВА ЗА ВЕТЕРИНУ  
Број: 323-03-01716/2018-05-2  
Датум: 1.3.2018 године  
Београд

Ев. бр: 188012 У.Н./5.1

На основу члана 23. став 2. Закона о државној управи ("Службени гласник РС" број 79/2005, 101/2007 и 95/2010) в.д. директор Управе за ветерину, Министарства пољопривреде, шумарства и водопривреде, решавајући по захтеву AUTO LL LOGISTIK D.O.O., Bulevar Oslobođenja 17, Čačak, Србија број 323-03-01716/2018-05-1 од 21.2.2018 године, а на основу члана 124. Закона о ветеринарству ("Службени гласник РС" бр. 91/2005 и 30/2010 и 93/2012), и члана 136. Закона о општем управном поступку ("Службени лист РС" бр. 18/2016), а на основу решења министра Министарства пољопривреде, шумарства и водопривреде број: 119-01-5/14/2017-09 од 30.6.2017. године доноси

### РЕШЕЊЕ

Утврђује се да не постоје ветеринарско-санитарне сметње за увоз пошиљке:  
mešovita hrana - MEŠOVITI PROIZVODI - SLADOLEDI, у количини од: 300000 kg  
Земља порекла пошиљке: REPUBLIKA ČEŠKA  
Земља складиштења пошиљке: REPUBLIKA SLOVENIJA  
Испоручилац: LJUBLJANSKE MLEKARNE, LJUBLJANA, SLOVENIJA  
Увозник: OAZA COMPANY SH.P.K., Aktashi III br. 50, PRIŠTINA, Србија  
Корисник: OAZA COMPANY SH.P.K., Aktashi III br. 50, PRIŠTINA, Србија  
Увоз ће се обавити преко граничне ветеринарске станице: BATROVCI  
Место складиштења робе у Србији: OAZA COMPANY SH.P.K., Aktashi III br 50, PRIŠTINA  
Ветеринарски контролни број објекта: CZ 771 ES; SI M 155 ES

### ВЕТЕРИНАРСКО-САНИТАРНИ УСЛОВИ ЗА УВОЗ МЕШОВИТИХ ПРОИЗВОДА КОЈИ У СВОМ САСТАВУ САДРЖЕ ПРОИЗВОДЕ ОД МЕСА, ПРОИЗВОДЕ ОД МЛЕКА, ПРОИЗВОДЕ ОД ЈАЈА И ПРОИЗВОДЕ РИБАРСТВА

I. Сваку пошиљку мора да прати ветеринарско-санитарно уверење у коме овлашћени ветеринар земље извознице потврђује:

- да роба у пошиљци одговара условима прописаним Ветеринарском конвенцијом (билатерално усаглашени сертификат) између Србије и земље извознице, или:

I.1 Мешовити производ који садржи производ меса, производ од меса испуњава следеће услове:

- да месо употребљено за производњу производа од меса мора бити од животиња које су провеле најмање три месеца пре клања или ако су млађе од три месеца, од рођења, на територији или делу територије земље извознице:

1. која је током последњих 12 месеци била слободана од следећих болести на које су животиње, од којих месо потиче пријемчиве и то: говеђа куга, слинавка и шал, Афричка куга свиња, заразна узетост свиња (Тешенска болест);
2. на којој није спроведена вакцинација у току последњих 12 месеци против болести споменутих под (I.1), на које су животиње од којих месо потиче пријемчиве; и још
3. У случају свежег меса свиња:
  - на којој током последњих 12 месеци није било појаве класичне куге свиња
4. У случају свежег меса копитара:

### Shtojca 3

× +

ure | [transparency.cefta.int/admin/mabd/mycases/](https://transparency.cefta.int/admin/mabd/mycases/)

Case	Reporting Party	Sector / Service Category	Product	Party Applying Measures	Status
<a href="#">15</a>	Kosovo*	All / N/A	N/A	Serbia	Solved
<a href="#">27</a>	Kosovo*	All / N/A	N/A	Serbia	Solved
<a href="#">31</a>	Kosovo*	All / N/A	N/A	Serbia	Solved
<a href="#">50</a>	Kosovo*	Live Animals; Animal Products / N/A	N/A	Serbia	Solved
<a href="#">72</a>	Kosovo*	Prepared Foodstuffs; Beverages, Spirits and Vinegar; Tobacco and Manufactured Tobacco Substitutes / N/A	230630	Serbia	Solved
<a href="#">90</a>	Kosovo*	Prepared Foodstuffs; Beverages, Spirits and Vinegar; Tobacco and Manufactured Tobacco Substitutes / N/A	N/A	Serbia	Solved
<a href="#">91</a>	Kosovo*	Vegetable Products / N/A	12079	Serbia	Solved
<a href="#">99</a>	Kosovo*	Animal or Vegetable Fats and Oils and Their Cleavage Products; Prepared Edible Fats; Animal or Vegetable Waxes / H Transportation and Storage	150110	Serbia	Solved
<a href="#">101</a>	Kosovo*	N/A / S Other Service Activities	N/A	Serbia	Solved
<a href="#">126</a>	Kosovo*	Products of the Chemical or Allied Industries / N/A	310590	Serbia	Solved
<a href="#">135</a>	Kosovo*	Mineral Products / N/A	271112	Serbia	New
<a href="#">137</a>	Kosovo*	Prepared Foodstuffs; Beverages, Spirits and Vinegar; Tobacco and Manufactured Tobacco Substitutes / N/A	220210	Serbia	New
<a href="#">141</a>	Serbia	Vegetable Products / N/A	110100	Kosovo*	New
<a href="#">142</a>	Serbia	Vegetable Products / N/A	110100	Kosovo*	New
<a href="#">143</a>	Serbia	All / N/A	000000	Kosovo*	New
<a href="#">144</a>	Serbia	All / N/A	000000	Kosovo*	New

Reporting Party

ure | [transparency.cefta.int/admin/mabd/mycases/](http://transparency.cefta.int/admin/mabd/mycases/)

Home Portal Survey Links FAQ Sitemap User **Search**

### My Cases

Show  entries Search:

Case	Reporting Party	Sector / Service Category	Product	Party Applying Measures	Status
<a href="#">100</a>	Kosovo*	Vegetable Products / K Financial and Insurance Activities	080590	Bosnia and Herzegovina	<span>Solved</span>
<a href="#">16</a>	Kosovo*	All / N/A	N/A	Bosnia and Herzegovina	<span>Solved</span>
<a href="#">28</a>	Kosovo*	All / N/A	N/A	Bosnia and Herzegovina	<span>Solved</span>
<a href="#">30</a>	Kosovo*	All / N/A	N/A	Bosnia and Herzegovina	<span>Solved</span>
<a href="#">146</a>	Bosnia and Herzegovina	All / N/A	000000	Kosovo*	<span>New</span>
<a href="#">1</a>	Bosnia and Herzegovina	Live Animals; Animal Products / N/A	040120	Kosovo*	<span>Solved</span>
<a href="#">39</a>	Bosnia and Herzegovina	Live Animals; Animal Products / N/A	040120	Kosovo*	<span>Solved</span>
<a href="#">120</a>	Bosnia and Herzegovina	Live Animals; Animal Products / N/A	040120	Kosovo*	<span>Solved</span>
<a href="#">78</a>	Bosnia and Herzegovina	Wood and Articles of Wood; Wood Charcoal; Cork and Articles of Cork; Manufactures of Straw, of Esparto or of Other Plaiting Materials; Basketware and Wickerwork / N/A	440710	Kosovo*	<span>Solved</span>
<a href="#">81</a>	Bosnia and Herzegovina	All / N/A	N/A	Kosovo*	<span>Solved</span>

Showing 1 to 10 of 10 entries (filtered from 35 total entries) Previous  Next

Copyright © 2016 [CEFTA Secretariat](#)  
 \* This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSC 1244 and the ICJ Opinion on the Kosovo\* declaration of independence.